

**Vaksinimi i fëmijëve
i domosdoshëm para
fillimit të vitit shkollor**

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DIMAL BASHA ZGJIDHET KRYEPARLAMENTAR, KONSTITUIMI NGEÇ TE VOTIMI I NËNKRYETARIT SERB

FAQE 4-5



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha, u zgjodh të martën kryetar i Kuvendit me 73 vota për, 30 kundër dhe tri abstenime. Ai arriti t'i marrë votat e nevojshme falë votës së një pjesë të deputetëve të PDK-së, AAK-së dhe një pjese të pakicave. LDK-ja

dhe Lista Serbe votuan kundër. Kuvendi zgjodhi edhe tre nënkryetarë nga partitë shqiptare: Albulena Haxhiu, Vlora Çitakun dhe Kujtim Shalën. Ndërkaq Emilija Rexhepi u zgjodh nënkryetare nga pakicat joserbe, ndërsa konstituimi i

Kuvendit ngeci te votimi i kandidatit për nënkryetar nga pakica serbe. Kryeparlamentari Basha e ka ndërprerë seancën e Kuvendit në mungesë konsensusi për emrin e nënkryetarit serb, për t'u takuar sërish të enjten në orën 11:00

**HAPET
URA E
RE PËR
AUTOMJETE
MBI LUMIN
IBËR**

F. 3



**VUÇIQ NË TAKIM ME
SORENSENIN:
DIALOGU ME KOSOVËN
TË PËRQENDROHET
TE ASOCIACIONI
DHE TE TË DREJTAT
E SERBËVE**

F. 2



**DEFICITI TREGTAR PREJ 16,2%
NË MUJIN KORRIK**

F. 8

**GUVERNATORI ISMAILI PRITET NË
SELINË E EIOPA-S, DISKUTOHET
PËR FUSHËN E SIGURIMEVE DHE
PENSIONEVE**

F. 8

SPORT



**LEON AVDULLAHU ZGJODHI
KOSOVËN, ZHËNJEHET ZVICRA**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rubio bisedon për luftën në Ukrainë me homologët evropianë

WASHINGTON, 26 GUSHT - Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, e zhvilloi një bisedë me homologët e tij evropianë në lidhje me përpjekjet diplomatike për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, njoftoi Departamenti amerikan i Shtetit të hënën vonë.

Rubio bisedoi me sekretarin e Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy, ministrin e Jashtëm të Ukrainës, Andrii Sybiha, ministrin e Jashtëm të Finlandës, Elina Valtonen, dhe shefën e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas,

tha një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit në një deklaratë.

Ministri ukrainas Sybiha tha se Ukraina është mirënjohëse ndaj Rubios për përpjekjet e tij dhe ndaj presidentit amerikan, Donald Trump, për "udhëheqjen e tij drejt arritjes së paqes".

Ai shtoi se garancitë e sigurisë për Ukrainën janë thelbësore. "Unë përsërita qëndrimin e Ukrainës se garancitë e sigurisë duhet të jenë konkrete, juridikisht detyruese dhe efektive. Ato duhet të jenë shumë dimensionale, duke

përfshirë nivele ushtarake, diplomatike, juridike dhe të tjera", shkroi Sybiha në X. "Të gjithë ndajmë bindjen se ushtria ukrainase është niveli themelor i çdo garancie të tillë, prandaj forcimi maksimal i saj është prioriteti ynë kryesor", shtoi ai.

Trump, pas takimeve të ndara me presidentin rus, Vladimir Putin, dhe më vonë me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, si dhe me liderët evropianë, i ka kërkuar Rubios të udhëheqë bisedimet për ofrimin e garancive të sigurisë për Ukrainën.



Australia e fajëson Iranin për dy sulme antisemitike, ia dëbon ambasadorin

CANBERRA, 26 GUSHT - Australia e ka akuzuar të martën Iranin për kryerjen e dy sulmeve antisemitike me zjarrvënje në dy qytete të vendit, Sidnei dhe Melburn, si edhe e urdhëroi ambasadorin iranian të largohet nga vendi brenda shtatë ditësh.

Ky është dëbimi i parë i këtij lloji që nga Lufta e Dytë Botërore. Që nga fillimi i luftës së Izraelit në Rripin e Gazës në tetor të vitit 2023, shtëpitë, shkollat, sinagogat dhe automjetet në Australi janë vënë në shënjestër të vandalizmave dhe zjarrvënjeve antisemitike.

Kryeministri i Australisë,

Anthony Albanese, tha se Agjencia Australiane për Inteligjencë dhe Siguri ka mbledhur të dhëna të besueshme se Irani kishte drejtuar të paktën dy nga këto sulme. "Këto ishin akte të jashtëzakonshme dhe të rrezikshme agresioni, të orkestruara nga një shtet i huaj në tokën australiane", tha Albanese në një konferencë për shtyp.

"Ishin përpjekje për ta minuar kohezionin social dhe për të mbjellë përçarje në komunitetin tonë", nënvizoi ai.

Sipas tij, Irani ishte përpjekur ta "fshihte përfshirjen e vet" në



sulmet e vitit të kaluar ndaj një restoranti në Sidnei dhe ndaj Sinagogës Adass Israel në Melburn.

Albanese shtoi se agjencia e

sigurisë së Australisë vlerëson se është e mundur që Irani të ketë drejtuar edhe sulme të tjera.

Australia i ka pezulluar operacionet në Ambasadën e vet në Teheran dhe të gjithë diplomatët e saj janë të sigurt në një vend të tretë, tha kryeministri, duke shtuar se Qeveria e tij do ta shpallë Korpusin e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit si organizatë terroriste.

Ministria e Jashtme e Australisë, Penny Wong, tha se ambasadori Ahmad Sadeghi dhe tre zyrtarë iranianë kanë shtatë ditë kohë për t'u larguar.

Kjo do të jetë hera e parë që një ambasador dëbohet nga Australia që prej Luftës së Dytë Botërore.

Ambasada e Izraelit në Australi e mirëpriti këtë veprim ndaj rivalit të saj kryesor, Iranit. "Regjimi i Iranit nuk përbën kërcënim vetëm për hebrejnë ose Izraelin, ai rrezikon gjithë botën e lirë, përfshirë Australinë", tha Ambasada izraelite në X.

Izraeli dhe Irani e zhvilluan një luftë ajrore 12-ditore në qershor, pasi Izraeli nisi sulme ndaj objekteve bërthamore të Iranit. Rreth 90,000 njerëz të lindur në Iran jetojnë në Australi.

Trumpi urdhëron masa ndëshkuese ndaj djegies së flamurit amerikan

WASHINGTON, 26 GUSHT - Presidenti amerikan, Donald Trump e ka nënshkruar të një urdhër ekzekutiv duke urdhëruar sistemin gjyqësor që t'i ndëshkojë ata që djegin apo përdhosin flamurin amerikan. "Nëse digjni një flamur, ju do të burgoseni për një vit, pa mundësi për të dalë më herët", ka thënë Trump teksa



e ka nënshkruar urdhrin në Zyrën Ovale.

Urdhri udhëzon gjyqtarët që t'i ndëshkojnë njerëzit që shkelin ligjet për përdhosjen e flamurit dhe të ngrenë padi për të sqaruar fushëveprimin e Amendamentit të Parë lidhur me këtë çështje.

Ai, gjithashtu, ka kërkuar që shkelësve t'i u pezullohen vizat, lejet e qëndrimit dhe

procedurat e naturalizimit.

"Flamuri amerikan është simbol i jetës tonë kombëtare, i cili duhet t'i bashkojë dhe përfaqësojë të gjithë amerikanët", është thënë në urdhër. "Përdhosja është vepër shumë ofenduese dhe provokative. Është deklaratë përbuzjeje, armiqësie dhe dhune kundër kombit tonë", është thënë

mes tjerash në dokument.

Administrata Trump ka thënë se në vendimin e Gjykatës Supreme për Amendamentin e Parë nuk mbrohen veprimet sikurse përdhosja e flamurit amerikan.

Mirëpo, Gjykata Supreme ka thënë më 1989 se djegia, apo shkatërrimi i flamurit kombëtar, mbrohet si e drejtë e shprehjes së lirë.

Siria thotë se Izraeli e ka marrë kontrollin e një toke afër malit Hermon

DAMASKU, 26 GUSHT - Siria ka thënë se Izraeli i ka dërguar 60 ushtarë për të marrë kontrollin e një zone brenda kufirit sirian, afër malit Hermon, në një operacion që ia ka shkelur sovranitetin dhe përbën kërcënim të mëtejshëm për sigurinë rajonale.

Një zëdhënës i ushtrisë izraelite ka thënë se trupat kanë kryer aktivitet rutinor në një zonë në jug të Sirisë, mirëpo nuk kanë

operuar në Beit Jin, zonë e afërt me kufirin me Libanin dhe afër malit Hermon.

Ky incident vjen teksa dy shtetet janë të angazhuara në bisedimet e ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara për ulje tensionesh në jug të Sirisë.

Damasku shpreson në arritjen e një marrëveshjeje për siguri, e cila më pas mund të hapte rrugën për bisedime më të gjera politike.

Ministria siriane ka thënë se

incidenti i së hënës ka ndodhur në majën strategjike në drejtim të Beit Jinit. Sipas banorëve të zonës, Izraeli i ka arrestuar edhe gjashtë sirianë atje.

Ushtria izraelite ka thënë se nuk ka kryer arrestime në jug të Sirisë, mirëpo e ka ndaluar një person për ta marrë në pyetje, pasi janë identifikuar disa persona në atë zonë që ushtria i ka parë si rrezik.

Kjo zonë është e njohur për kontrabandim armësh nga grupi



i Libanit, Hezbollah dhe fraksione tjera xhihadiste.

Hezbollahu, grup i afërt me

Iranin, është i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi tjera.

AGK-ja dënon përjashtimin arbitrar nga ekrani të 6 gazetarëve të RTK-së

PRISHTINË, 26 GUSHT - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), e ka pranuar me shqetësim njoftimin e 6 gazetarëve të RTK-së për largimin e tyre nga ekrani dhe emisionet që i drejtonin ata në Televizionin Publik. Blerta Foniqi Kabashi, Meneta Zekaj Nushi, Arton Mulliqi, Edona Musa-Mustafa, Jehona Zhitia dhe Valon Bajrami kanë njoftuar se menaxhmenti, pa paralajmërim, të premtën e kaluar, i ka njoftuar se janë përjashtuar nga moderimi i magazinave informative të orës

17:00 dhe të orës 23:00. AGK-ja e dënon fuqishëm këtë vendim arbitrar të menaxhmentit të RTK-së, që paraqet një nivel të paprecedent të censurës në Transmetuesin Publik. AGK-ja e sheh veprimin e menaxhmentit si ndëshkim ndaj 6 gazetarëve për punën e tyre profesionale, të pandikuar politikisht dhe për ngritjen e zërit për vonesën e pagave. Kjo është një dëshmi e re, të shqetësimit të ngritur me kohë nga AGK-ja, se Menaxhmenti aktual është vënë në shërbim të

plotë të Qeverisë Kurti, dhe partisë politike në pushtet, Vetëvendosje. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e fton menaxhmentin që ta rishikojë dhe tërheqë këtë vendim, dhe t’ua mundësojë gazetarëve dhe redaktorëve të bëjnë punën e tyre në interes të publikut, pa ndikimin e vazhdueshëm politik. AGK-ja ka theksuar se do të përkrahë të 6 kolegët gazetarë në të gjithë hapat që ata do të ndërmarrin për të sfiduar këtë vendim të papranueshëm dhe të ndikuar nga politika.



HAPET URA E RE PËR AUTOMJETE MBI LUMIN IBËR

MITROVICË, 26 GUSHT - Mëngjesin e së martës është hapur njëra prej dy urave që Qeveria në detyrë e Kosovës nisi t'i ndërtojë muaj më parë mbi lumin Ibër, i cili e ndan Mitrovicën në jugun e banuar me shqiptarë dhe në veriun e banuar me serbë. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, shkroi në "Facebook" se "më pak se dy muaj u deshën për të ngritur urën e 36-të në Kosovë mbi lumin Ibër". "Ura për kalimin e automjeteve nga sot prej orës 9:00 është hapur për qarkullim", shkroi ai. Më herët, ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, publikoi një fotografi të veturave duke kaluar mbi urën e re dhe shkroi: "Të dashur qytetarë të Mitrovicës dhe gjithë Kosovës, urime ura e re". Autoritetet kosovare e filluan ndërtimin e dy urave në të dy krahët e urës kryesore mbi lumin Ibër, me gjithë kundërshtimet nga serbët lokalë dhe reagimet e bashkësisë ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës ka thënë vazhdimisht se ndërtimi i këtyre urave - njëra për këmbësorë dhe tjetra për automjete - ka për qëllim t'i lidhë Mitrovicën e Veriut me Mitrovicën e Jugut, qytet i ndarë etnikisht që nga paslufta. Ajo i ndau rreth tre milionë euro për ndërtimin e tyre dhe tha se të dyja do të përfundonin në vjeshtë. Ndërtimi i tyre u kundërshtua edhe nga Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë që gëzon përkrahjen e Beogradit, e



cili ngriti dhe një petitionin kundër saj, i cili i mori mbi 3.500 nënshkrime. Bashkimi Evropian ka thënë se ndërtimi i dy urave të reja mbi lumin Ibër në Mitrovicë "ka rëndësi praktike dhe politike", dhe se çdo projekt infrastrukturor midis Mitrovicës

së Veriut dhe asaj të Jugut kërkon koordinim të ngushtë dhe dialog mes të gjitha komuniteteve të përfshira. "Është e domosdoshme që këto projekte të pasqyrojnë vullnetin dhe nevojat e komuniteteve lokale", është thënë në përgjigje. Ndërkohë, teksa punimet për

ndërtimin e tyre filluan, prokurorët njoftuan se kishin autorizuar hetime, për shkak të dyshimeve për keqpërdorim të mundshëm të fondeve publike në procesin e lidhjes së kontratës me kompaninë përkatëse. Më 10 korrik, Prokuroria konfirmoi zyrtarisht se autorizoi

Policinë e Kosovës për të hetuar mënyrën e lidhjes së kontratës për këtë projekt, por nuk ka ndarë të dhëna të tjera. Ura e reja po ndërtohen pranë urës kryesore mbi Ibër, e cila është pjesë e Marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes të arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi. Kjo urë është e njohur për përplasjet etnike pas luftës dhe për këtë arsye është nën mbikëqyrjen e forcave të KFOR-it. Ura kryesore është e hapur vetëm për këmbësorë, ndërsa Qeveria e Kosovës kishte paralajmëruar hapjen e saj për komunikacion në korrik të vitit të kaluar - gjë që pati shkaktuar tensione dhe reagime nga bashkësia ndërkombëtare. Kosova dhe Serbia ishin pajtuar që ura të hapej për qarkullim në vitin 2014, në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve. Ishte paraparë revitalizimi i urës dhe largimi i të gjitha barrikadave të vendosura nga serbët lokalë. Në vitin 2016 u arrit marrëveshje për një plan të ri zbatimi, për të tejkaluar mosmarrëveshjet rreth interpretimeve të marrëveshjeve të mëparshme. Sipas këtij plani, ura duhej të hapej për komunikacion në janar të vitit 2017. Punimet për revitalizim përfunduan në qershor të vitit 2018, ndërsa ura - në të cilën janë investuar 1.5 milionë euro - nuk është hapur kurrë për automjete, por vetëm për këmbësorë.

Vaksinimi i fëmijëve i domosdoshëm para fillimit të vitit shkollor

Prishtinë, 26 gusht - Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës kanë bërë thirrje që të vaksinohen fëmijët para fillimit të vitit shkollor. "Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ju bëjnë thirrje që të siguroheni që fëmijët tuaj të

kenë marrë të gjitha vaksinat e parashikuara sipas Kalendarit të Rregullt të Vaksinimit, para fillimit të vitit të ri shkollor dhe paraqitjes në çerdhe e kopshte. Ju rikujtojmë se: Vaksinat janë të sigurta dhe mbrojnë fëmijët nga sëmundje të rënda e ngjitëse; Vaksinimi në kohë ndihmon në parandalimin e shpërthimeve të sëmundjeve

në komunitet; Shëndeti i fëmijës suaj është mbrojtja më e mirë për të dhe për shoqërinë. Ju ftojme që të vizitoni Qendrën tuaj më të afërt të Mjekësisë Familjare për të kryer vaksinimin para fillimit të vitit shkollor", ka njoftuar Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.





DIMAL BASHA ZGJIDHET KRYEPARLAMENTAR, KONSTITUIMI NGEÇ TE VOTIMI I NËNKRYETARIT SERB

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha, u zgjodh të martën kryetar i Kuvendit me 73 vota për, 30 kundër dhe tri abstenime. Ai arriti t'i marrë votat e nevojshme falë votës së një pjesë të deputetëve të PDK-së, AAK-së dhe një pjese të pakicave. LDK-ja dhe Lista Serbe votuan kundër. Kuvendi zgjodhi edhe tre nënkryetarë nga partitë shqiptare: Albulena Haxhiun, Vlora Çitakun dhe Kujtim Shalën. Ndërkaq Emilija Rexhepi u zgjodh nënkryetare nga pakicat joserbe, ndërsa konstituimi i Kuvendit ngeci te votimi i kandidatit për nënkryetar nga pakica serbe. Kryeparlamentari Basha e ka ndërprerë seancën e Kuvendit në mungesë konsensusi për emrin e nënkryetarit serb, për t'u takuar sërish të enjten në orën 11:00

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 26 GUSHT - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Dimal Basha, është zgjedhur kryetar i Kuvendit të Kosovës të martën. Zgjedhja e Bashës kryeparlamentar i hap rrugën konstituimit të Kuvendit dhe formimit të Qeverisë së re, pas një ngërçi të gjatë politik, pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Basha i mori 73 vota për, 30 kundër, ndërsa tetë deputetë abstenuan. Ai arriti t'i marrë votat e nevojshme falë votës së një pjesë

të deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe një pjese të pakicave. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lista Serbe votuan kundër. PDK-ja ishte kritikuar që nuk e kishte votuar Bashën për kryetar të Kuvendit në seancën e kaluar, pasi ishte shprehur se do t'i votonte kandidatët e Vetëvendosjes që nuk ishin ministra në Qeverinë Kurti II. Deputetët e zgjedhur në zgjedhjet e 9 shkurtit e votuan kryetarin e Kuvendit në përpjekjen e 58-të të tyre.

Kuvendi zgjodhi edhe tre nënkryetarë nga partitë shqiptare: Albulena Haxhiun, Vlora Çitakun dhe Kujtim Shalën. Ndërkaq Emilija Rexhepi u zgjodh nënkryetare nga pakicat joserbe, ndërsa konstituimi ngeci te votimi i kandidatit për nënkryetar nga pakica serbe. Sllavko Simiq është propozuar tri herë dhe ka dështuar t'i marrë votat e nevojshme. Pastaj kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, ka marrë vendim që zgjedhja e nënkryetarit serb të kalojë në formatin me short. Ai e ka arsyetuar këtë vendim duke e përmendur aktgjykimin e

Gjykatës Kushtetuese, e cila ka përcaktuar në vendimin e disa ditëve më parë se një kandidat mund të propozohet deri në tri herë. Edhe me short dështoi votimi i emrave për nënkryetar të Kuvendit që u përzgjedhën nga deputetët e Listës Serbe. Kryetari i Partisë Serbe për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Nenad Rashedi ka qenë propozimi i radhës për nënkryetar Kuvendi. Ai i ka siguruar vota 55 për, një kundër dhe 17 abstenime, duke mos u zgjedhur nënkryetar. Kryeparlamentari Basha e ka ndërprerë seancën e Kuvendit në mungesë konsensusi për emrin e nënkryetarit serb. Duke qenë se asnjëri prej kandidatëve të dalë nga shorti nuk i kanë siguruar votat e nevojshme, ai ka kërkuar ndaljen e punimeve, për t'u takuar sërish të enjten në orën 11:00.

Kush është Dimal Basha?

Sipas biografisë së publikuar në

uebfaqen e Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha ka lindur më 12 tetor 1979 në Prishtinë dhe jeton në qytetin e Ferizajt. Studimet e larta i ka përfunduar në "John Jay College of Criminal Justice" në Nju Jork, duke diplomuar me vlerësimin më të lartë në drejtimin "E Drejta Penale Ndërkombëtare." Basha, gjithashtu, ka përfunduar studimet Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, me fokus në "Konflikt dhe Siguri", në Universitetin "The Neë School University", po ashtu në Nju Jork. Në politikë, ai ka shërbyer si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës për dy mandate dhe tashmë është zgjedhur për herë të tretë. Ai ka qenë anëtar në Komisionin për Punë të Jashtme, Komisionin për Legjislacion, Komisionin për Mbikëqyrjen e AKI-së dhe Komisionin për Stabilizim-Asociim. Ekspertët e medias e konsiderojnë ndër sulmuesit më të mëdhenj të gazetarëve dhe aktivistëve në Kosovë.

Basha bën thirrje për bashkëpunim

Në fjalimin e tij të parë pasi u zgjodh në krye të organit ligjvënës, Basha foli për përgjegjësinë që ndien, rëndësinë e Kuvendit dhe u bëri thirrje deputetëve për bashkëpunim. “Derisa ndiej nderin dhe mirënjohjen për votën tuaj, ndiej edhe përgjegjësinë e madhe që më është besuar. Kuvendi është zemra e demokracisë sonë, vendi ku përfaqësohen zërat e të gjithë qytetarëve”, tha Basha. Ai theksoi se Kosova “është e ndërtuar mbi sakrifica dhe mbi besimin e përbashkët se liria dhe shteti jonë janë më të mëdha se çdo interes i përveçëm. Republika jonë është e ndërtuar mbi sakrifica të panumërta: mbi gjakun, mundin dhe qëndresën e atyre që besuan se e ardhmja e kombit ishte më e rëndësishme se vetë jeta e tyre”. “Një përlule dhe falënderim nga zemra u takon grave, vajza, pra nënave dhe motrave tona, të cilat brez pas brezi sakrifikuan, rritën, punuan në heshtje dhe ofruan dashuri dhe përkushtim. Ato ishin dhe mbesin themeli i një shoqërie të shëndoshë që ne e gëzojmë”, nënvizoi Basha. Ai shtoi se mbrojtja e Kosovës duhet të jetë detyrë e të gjithëve, pushtetit dhe opozitës, pavarësisht se ai pret dallime të mëdha mes partive, sepse “jetojmë në një demokraci”. “Ju bëj thirrje për bashkëpunim. Është koha të dëshmojmë se pavarësisht dallimeve politike, ne e kemi guximin dhe mençurinë për të punuar së bashku për interesin më të lartë për vendin tonë”, theksoi ai. Ai gjithashtu i bëri thirrje Serbisë ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Basha u zgjodh pas disa dështimesh pas publikimit të plotë të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese më 18 gusht, i cili i urdhëron deputetët ta bëjnë Kuvendin e ri brenda një afati 30-ditor. Në tri seancat e kaluara, partia fituese, Lëvizja Vetëvendosje - të cilës i takon të propozojë kandidat për kryeparlamentar, i kishte hedhur pesë kandidatë në votim, por asnjëri prej tyre nuk i kishte marrë të paktën 61 votat e nevojshme për t’u zgjedhur. Asnjëri prej Albulena Haxhiut, Hekuran Muratit, Arbërie Nagavcit, Donika Gërvallës, Dimal Bashës, nuk ia kanë dalë t’i marrin më shumë se 57 vota. Lulzim Peci, nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) në Prishtinë, ka shkruar në “Facebook” se edhe nëse Nenad Rashiq zgjidhet nënkryetar, “ka shumë gjasa që Gjykata Kushtetuese të konstatojë se Kuvendi sot nuk është konstituuar ligjërisht”. Sipas tij, loja që u zhvillua në KQZ, kur u votua të mos certifikohet Lista Serbe për zgjedhjet lokale, po vazhdon në Kuvendin e Kosovës, “dhe kjo, për mobilizimin e militantëve në prag të zgjedhjeve lokale”. “Mbi të gjitha, patriotizmi - pa të cilin kjo fjalë, që tashmë ‘shitet lirë’, nuk ka kuptim - është, para së gjithash, respektimi i ligjeve dhe i Kushtetutës së vendit; gjithçka tjetër është vetëm populizëm i lodhur. Kjo vlen për të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, veçanërisht për kryetarin e sapozgjedhur, Basha”, ka theksuar Peci. Albert Krasniqi nga organizata Demokraci Plus në Prishtinë ka thënë përmes një postimi në “Facebook” se procedura për zgjedhjen e dy nënkryetarëve të Kuvendit që përfaqësojnë

komunitetet joshumicë duhet të përsëritet, pasi mënyra e ndjekur nuk është në përputhje me Kushtetutën. “Zgjedhja e tyre duhet të bëhet me një votim të vetëm, në bllok, për të dy kandidatët. Kandidati për nënkryetar nga komuniteti serb mund të propozohet vetëm nga Lista Serbe, e cila përfaqëson shumicën e deputetëve të këtij komuniteti, dhe jo nga subjekte të tjera politike”. Sipas Krasniqit, aktivizimi i procedurës me short për përzgjedhjen e kandidatit mund të bëhet vetëm në rastet kur nuk ka propozime dhe nënkrjetarët në prani të deputetëve të komunitetit përkatës. Pa pjesëmarrjen e tyre, shorti nuk mund të zhvillohet. Mes tjerash, Krasniqi ka thënë se skenari për të shteruar kandidaturat e Listës Serbe me qëllim që pozita t’i kalojë ZSPO-së së Nenad Rashiqit, nuk mund të realizohet pa miratimin e shumicës së deputetëve të këtij komuniteti. Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, ka thënë se votimi për nënkryetarët është jokushtetues, pasi që procesi nuk zhvillohet ndaras dhe as nuk mund të imponohen kandidatët nga deputetët e tjerë. “Ndoshta edhe këtë do ta zgjidhë Gjykata Kushtetuese. Qëllimshëm po vazhdohet me bllokadë!”, ka thënë ai përmes një postimi në rrjete sociale. Për të dërguar një lëndë në Gjykatën Kushtetuese janë të domosdoshme nënshkrimet e 10 deputetëve.

Reagimet për zgjedhjen e Dimal Bashës për kryeparlamentar

Kreu i Partisë Demokratike të

Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, theksoi se partia e tij votoi për të zhbllokuar situatën e konstituimit të Kuvendit. “Në një situatë normale, në një botë paralele, asnjëherë nuk do të votonim dikë si Dimali [Basha] në krye të Kuvendit. Por, sot kemi votuar për të zhbllokuar situatën”. Ai tha se nuk beson që as deputetët e Vetëvendosjes janë të lumtur me zgjedhjen e Dimal Bashës për kryeparlamentar, por se kjo ishte zgjedhja e Albin Kurtit dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV). “Shpresoj shumë që sot do të zgjedhim edhe nënkryetarët, në mënyrë që ta konstituojmë Kuvendin dhe të hyjmë në afatet kushtetuese”, tha Krasniqi. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, e ka cilësuar zgjedhjen e Dimal Bashës kryeparlamentar si “një fitore e injorancës dhe një gabim i pafalshëm i mbështetësve të saj”. “Kosova, siç se kishim menduar asnjëherë”, shkroi ai në Facebook. Abdixhiku tha se Basha “përfaqëson nivelin e tyre”. “Kështu e projektojnë Republikën. Me këto vlera kanë zgjedhur të nderojnë dhe votuesit e popullin e Kosovës”, shtoi ai. LDK-ja e Abdixhikut votoi kundër Bashës. “Kosova duhet të aspirojë lartë. Aksidentet politike e triumfet e injorancës historike do të kapërcejnë. Dritë një ditë do të ketë”, përfundoi ai. Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, tha pas zgjedhjes së Dimal Bashës kryeparlamentar se partia e saj kishte vullnet të lirë për ta mbështetur atë, por jo të gjithë votuan njësoj. “Do të shohim se si do të zhvillohet seanca në vazhdim”, tha ajo.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, e ka kritikuar Lëvizjen Vetëvendosje se është vonuar në themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve të 4 shkurtit, duke thënë se ajo duhet të shpjegohet para qytetarëve. Limaj, i cili votoi kundër Dimal Bashën për kryetar të Kuvendit, tha pasi Basha u zgjodh: “Ishte votim pa marrëveshje politike, këtë kanë mundur ta bëjnë qysh në ditën e parë. Shpresoj se do ta kenë një shpjegim para qytetarëve të Kosovës”. Këshilltarja ligjore në Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, Flutura Kusari, tha se Dimal Basha është një ndër sulmuesit më të mëdhenj të gazetarëve dhe të aktivistëve në Kosovë. “Uroj që marrja e pozitës së re do të ndikojë sadopak që Basha të përmbahet dhe të menaxhojë më mirë mosdurimin e tij dhe të partisë së tij ndaj pushtetit të katërt”, shkroi Kusari në “Facebook”. Analisti Imer Mushkolaj tha se “për mirë e keq dhe me kosto politike, PDK e zhbllkoi situatën”. Ai kritikoi kreun e LDK-së, Lumir Abdixhikun, për deklaratën e tij se “ka fituar injoranca”. “Pse Lumir nuk dhe kontribut me e pengu këtë situatë, pse e lejove ‘fitoren e injorancës’? Si parti ‘institucionaliste’, LDK e ka pasë mundësinë me vepru, por nuk ka dashtë. Tash kryetari po vajton. Dobët, shumë dobët”. Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë e ka uruar Dimal Bashën për emërimin e tij në krye të organit ligjvënës të Kosovës. Përmes një postimi në “Facebook”, ajo shkroi se “shpresojmë se Kosova tani do të jetë në gjendje t’i formojë institucionet.



Zyrtarë të lartë nga Policia e Kosovës marrin pjesë në konferencën vjetore të NIAIA-s

PRISHTINË, 26 GUSHT - Zëvendësudrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti dhe eprorë të lartë nga PK-ja, janë duke marrë pjesë në konferencën vjetore të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Louisville, Kentucky të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Po ashtu, në këto konference vjetore, pjesëmarrës janë edhe

zyrtarë nga IPK-ja, të udhëhequr nga kryeshefi i IPK-së Hodaj. Delegacioni i Kosovës u mirëprit nga Kryetari i bordit të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme Kapiten Ray, anëtarët e Bordit dhe zyrtarë tjerë të delegacioneve të Agjencive Mbikëqyrëse Policore në ShBA. Kosova nga viti 2021 është anëtare e barabartë e kësaj

organizate si shtet i parë Evropian krahas Agjencive të zbatimit të ligjit në ShBA. Misioni i NIAIA-s është të përkrah, organizatat anëtare për të zhvilluar standardet më të larta të punës, integritetit, edukimit dhe profesionalizmit përmes diskutimeve në konferencë apo shkëmbimit të përvojave me delegacione tjera pjesëmarrëse në aspektin e hetimeve e brendshme.



HYSENI: KATËR VJET QEVERISJE, SHUMË SFIDA, POR EDHE SHUMË SUKSESE NË GJILAN

GJILAN, 26 GUSHT - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me nënkryetaren Leonora Morina Bunjakun dhe drejtorët, kanë diskutuar lidhur me punët e realizuara gjatë katër vjetëve të qeverisjes. “Në mbledhjen e fundit të bordit kemi rikapitulluar punët dhe projektet e realizuara, të cilat kapin vlerën mbi 45 milionë euro projekte në zbatim. Katër vite qeverisje, shumë sfida, por edhe shumë suksese”, tha Alban Hyseni. I pari i Gjilanit, tregon edhe për projektet: Rrjeti i ujësjellësit, projekti FLOWS në vlerë prej 15 milionë euro.



Stadiumi i Qytetit në vlerë 13 milionë euro. Banimi i përballueshëm dhe

social në vlerë prej 4.5 milionë euro. Kryetari i Gjilanit, tregoi edhe

për investimet në fushën e arsimit, ku 3.3 milionë euro janë për Shkollën e Mjekësisë dhe mbi 3 milionë euro në çerdhe të reja. Sipas tij, në fushën e bujqësisë janë mbi 2.8 milionë euro investime (2022–2024) dhe dhjetëra përfitues. I pari i Gjilanit tregoi se për renovimi i Palestrës së Sportit janë 2.8 milionë euro. Qëndrimi ditor për të moshuar, kuzhina humanitare dhe bujtina për studentë në vlerë prej 2.5 milionë euro. Rruga “Hamdi Kurteshi” në vlerë 2.4 milionë euro. Sipas kryetarit Alban Hyseni, në

fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale janë mbi 2 milionë euro në ndërtime, pajisje dhe shërbime të reja. Sipas të parit të Komunës së Gjilanit, krejt në fund të mandatit kanë nisur me projektin më kapital në historinë e komunës sonë, “Bulevardin e Qytetit”, me vlerë 18 milionë euro, që ndryshon tërësisht pamjen e qytetit. “Këto investime madhore, bashkë me qasjen e re në qeverisje, kanë transformuar qytetin tonë. Jam krenar për çdo hap të bërë dhe për besimin e qytetarëve në këtë rrugëtim”, tha kryetari Alban Hyseni.



IZMI ZEKA EMËROHET SHEF I SHTABIT ZGJEDHOR TË PDK-së NË GJILAN

GJILAN, 26 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës dega në Gjiatani ka emëruar Izmi Zekën shef të shtabit zgjedhor për zgjedhjet e 12 tetorit. Sipas njoftimit për medie, ky vendim pasqyron rëndësinë që PDK-ja i kushton organizimit dhe mobilizimit në prag të fushatës zgjedhore, duke i besuar këtë detyrë një personaliteti me përvojë të gjatë në politikë dhe institucione shtetërore. “Z. Izmi Zeka ka qenë për vite të tëra pjesë aktive e jetës politike dhe shoqërore në Kosovë, duke mbajtur funksione të ndryshme udhëheqëse dhe duke dëshmuar

përkushtim ndaj proceseve demokratike dhe zhvillimit të vendit. Me emërimin e tij, PDK-ja e Gjilanit synon të forcojë strukturat e brendshme dhe të garantojë një fushatë dinamike, gjithëpërfshirëse dhe fituese, duke mbështetur kandidatin për kryetar të komunës, z. Riad Rashiti. Përvoja e gjatë e Izmi Zekës në politikë dhe institucione është një garanci shtesë për suksesin tonë në zgjedhjet e 12 tetorit. Ai do të udhëheqë me profesionalizëm dhe përkushtim të madh punën e shtabit zgjedhor”, ka njoftuar dega e PDK-së në Gjiatani.

Kryetari i Rahovecit përkuilton dëshmorët Skender Kastrati dhe Sabri Morina

RAHOVEC, 26 GUSHT - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me familjarë, me bashkëluftëtarë dhe me qytetarë nga Malësia e Vogël dhe Vrajkata, nderuan në përvjetorin e rënies dëshmorët e kombit, Skender Kastrati dhe Sabri Morina, të cilët ranë për të mos vdekur

kurrë, më 26 gusht 1998. Kryetari Latifi ka thënë se Skender Kastrati dha kontribut të madh në luftën çlirimtare, duke ndihmuar furnizimin me armë e municione luftëtarët e lirisë. “Sot, emri i tij jeton në kujtesën tonë, ku shkolla dhe rruga e mbajnë emrin e tij.

Sabri Morina, i ri në moshë, u kthye nga kurbeti për t'i dhënë gjithçka atdheut dhe ra heroikisht në Goden të Hasit, krah shokëve të tij të armëve dhe të idealit. Lavdi të përgjeshme dëshmorëve të atdheut! Lavdi Skender Kastratit dhe Sabri Morinës!”, ka shkruar ai në “Facebook”.



Uran Ismaili prezanton pesë zgjidhjet për Prishtinën në Emshir, Hajvali dhe Matiqan

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka vazhduar takimet me vullnetarët e platformës “Koha për Prishtinën”, duke u ndalur këtë herë në lagjet Emshir, Hajvali dhe Matiqan. Në këto bashkëbisedime me qytetarët, Ismaili ka theksuar se një nga prioritetet e tij kryesore është zhblllokimi i trafikut në kryeqytet, i cili prej vitesh është bërë problemi më i madh i përditshëm për banorët. “Do ta zhblllokojmë trafikun brenda 18 muajsh me 100 autobusë të rinj, 60 semaforë shtesë dhe 5 parkingje ‘Park & Ride’ në

hyrjet e qytetit,” tha ai, duke e cilësuar këtë plan si hapin e parë drejt një Prishtine funksionale. Ismaili shtoi se angazhimi i qytetarëve në terren dhe përmes platformës www.kohaperprishtinen.com është forca që po i jep energji kësaj fushate dhe është garanci për realizimin e këtyre zgjidhjeve. “Vazhduam takimet me vullnetarë në Emshir, Hajvali dhe Matiqan. Do ta zhblllokojmë trafikun brenda 18 muajsh me 100 autobusë të rinj, 60 semaforë shtesë, dhe 5 parkingje ‘Park & Ride’ në hyrjet e qytetit!”, ka pohuar ai.



VUÇIQ NË TAKIM ME SORENSENIN: DIALOGU ME KOSOVËN TË PËRQENDROHET TE ASOCIACIONI DHE TE TË DREJTAT E SERBËVE

PRISHTINË, 26 GUSHT - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë pas një takimi në Beograd me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian (BE), Peter Sorensen, se është thelbësore që dialogu me Kosovën të “kthehet tek obligimi” për formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, si dhe te mbrojtja e të drejtave të serbëve. “Politika jonë është politika e paqes, e përkushtuar fuqishëm në kërkimin e zgjidhjeve kompromisi përmes dialogut, por edhe e vendosur dhe e përgjegjshme në mbrojtjen e interesave shtetërore e kombëtare”, shkroi Vuçiq më 26 gusht në Instagram, pas takimit me Sorensenin.

Ai shtoi se “përpjekja për ndalim” të pjesëmarrjes së Listës Serbe në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë tregon se “respektimi i të drejtave themelore dhe lirive të veprimit politik të serbëve është i rrezikuar”.

Vuçiq theksoi, gjithashtu, se me Sorensenin zhvilloi një bisedë të hapur, të fokusuar në mundësitë për vazhdimin e dialogut me Prishtinën, si dhe mbi sfidat që lidhen me pozitën e serbëve në Kosovë.



Sorensen, pas takimit me Vuçiqin, do të takohet edhe me drejtorin e Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković.

I dërguari i BE-së për dialogun kishte vizituar Prishtinën më 6 gusht, ku me zyrtarët kosovarë kishte diskutuar për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit.

I pyetur nga gazetarët mbi gjendjen aktuale të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Sorensen tha shkurt se procesi është “aktiv”.

Marrëveshja për të cilën bëhet fjalë u arrit mes dy palëve në vitin 2023.

Edhe pse nuk është nënshkruar,

BE-ja insiston se marrëveshja është detyruese.

Dokumenti prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë, njohjen reciproke të simboleve shtetërore, shmangien e bllokimit nga Serbia të anëtarësimit të Kosovës në

organizata ndërkombëtare, si dhe detyrimin që Prishtina dhe Beogradi të zbatojnë të gjitha marrëveshjet e mëparshme të arritura në dialog.

Rundi i fundit i dialogut Kosovë-Serbi, me ndërmjetësimin e BE-së, u mbajt më 10 qershor.

Pas këtij takimi, në nivel të kryenegociatorëve, Sorensen deklaroi se po bëhen përgatitje për një takim në nivel të lartë. Takim i tillë mes Kosovës dhe Serbisë nuk është zhvilluar që nga shtatori i vitit 2023.

Ai takim u mbajt pak ditë para se një grup serbësh të armatosur të sulmonte policinë e Kosovës në Banjskë, afër Zveçanit.

Kosova fajëson Serbinë për atë ngjarje, ndërsa Beogradi mohon çdo përfshirje.

Sorensen erdhi në Serbi në mes të një krize politike dhe protestave shumë mujore kundër qeverisë, që shpërthyen pas vdekjes së 16 personave në shembjen e çatisë së Stacionit Hekurudhor të Novi Sadit.

Protestuesit, përveç kërkimit të përgjegjësisë për këtë tragjedi, po ashtu kërkojnë mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare - kërkesë që autoritetet e refuzojnë.

Policia e Kosovës parandalon kontrabandë me cigare në vlerë rreth 80 mijë euro

PRISHTINË, 26 GUSHT - Policia e Kosovës, konkretisht njësitet policore të Departamentit të Kufirit, Njësia për Ndërhyrje të Shpejtë, në vazhden e aktiviteteve për luftimin e veprimeve të kundërligjshme ndërkufitare, kanë parandaluar një rast të kontrabandimit me mallra. Ekipet patrulluese të Njesisë për Ndërhyrje të Shpejtë-Veri, në realizim e sipër të një plani

taktik-operativ, bazuar në një informatë të pranuar, me datën 25.08.2025 në fshatin Cerajë - KK Leposaviq, kanë hasur në një automjet të braktisur kombi VW transporter, ngjyrë e bardhë, me targa RKS, i mbushur me cigare të llojeve të ndryshme, pa banderola, që dyshohet të jenë të kontrabanduara nga territori i Serbisë në Republikën e Kosovës.

Vlera e përgjithshme e mallit vlerësohet të jetë në total prej 797 000 copë cigare, me vlerë të përafërt prej 80 mijë (80 000) euro.

Me autorizim të prokurorit të Shtetit, automjeti dhe cigaret e kontrabanduara janë dërguar në terminalin doganor për trajtim të mëtejshëm nga njësitë përkatëse të PK-së dhe nga Dogana e Kosovës.



Guvernatori Ismaili pritet në selinë e EIOPA-s, diskutohet për fushën e sigurimeve dhe pensione

PRISHTINË, 26 GUSHT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, u prit në selinë e Autoritetit Evropian për Sigurime dhe Pensione (EIOPA) në Frankfurt, gjatë një vizite zyrtare.

Takimi u fokusua në zhvillimet e fundit në fushën e sigurimeve dhe pensione.

Petra Hielkema u informua mbi zhvillimet më të fundit në sektorin financiar të Kosovës, përfshirë kornizën ligjore dhe rregullative, si dhe përkushtimin

e BQK-së ndaj reformave të orientuara drejt përafrimit të sistemit financiar me atë të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, u diskutua për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në ngritjen e kapaciteteve, forcimin e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, si dhe harmonizimin e mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregullative, në kuadër të rrugëtimit integruar të Kosovës drejt BE-së. Ky takim u zhvillua në frymën e angazhimit të vazhdueshëm të

BQK-së me autoritetet përkatëse mbikëqyrëse financiare të Bashkimit Evropian.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin në nivel teknik dhe profesional, duke rikonfirmuar përkushtimin për avancimin e reformave që promovojnë stabilitetin financiar, zhvillojnë më tej sektorin e sigurimeve dhe pensione, nxisin edukimin financiar dhe konsolidojnë praktikën e mbrojtjes së konsumatorit.



DEFICITI TREGTAR PREJ 16,2% NË MUAJIN KORRIK

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin korrik 2025.

Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 16,2% në muajin korrik 2025, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024, gjegjësisht në vlerë prej 576,4 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 495,9 milionë euro në vitin 2024. Eksporti mbulon importin me 12,7%.

Eksporti i mallrave në muajin korrik 2025 kishte vlerën 83,8 milionë euro, ndërsa importi 660,2 milionë euro, që është një rënie prej (-2,4%) për eksport, si dhe një rritje prej 13,5% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 21,7% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 14,2% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, 12,5% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 8,5% e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; pijet dhe duhani; 7,4% e përbëjnë produktet minerale, etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 13,1% e përbëjnë produktet minerale; 13,1% e përbëjnë mjetet e transportit; 13,0% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12,0% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 8,8% e



përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 28,8 milionë euro, ose rreth 34,3% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 8,9%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (10,5%), Holanda (3,8%), Italia (3,5), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 283,1 milion euro, ose 42,9% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 4,5%. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (14,1%), Italia (4,8%), Polonia (3,8%), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 39,5 milionë

euro, ose 47,1% të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-12,4%). Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (18,0%), Maqedonia e Veriut (14,7%), Serbia (7,2%), Mali i Zi (5,3%), Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 79,6 milionë euro, ose 12,1% të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 19,4%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (4,2%), Shqipëria (3,7%), Serbia (3,1%).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 15,6 milionë euro, ose 18,6%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (8,3%) dhe Turqia (2,4%). Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 297,5 milionë euro, ose 45,1%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (14,5%) dhe Turqia (12,7%).

Mbi 1 mijë familje dhe 10 biznese përfitojnë nga subvencionimi për pajisje eficiente të energjisë

PRISHTINË, 26 GUSHT - Bashkimi Evropian ka ndarë 7.5 milionë euro shtesë për Kosovën në kuadër të Pakos së Mbështetjes Energjetike (IPA 2023), duke e rikonfirmuar mbështetjen e tij për tranzicionin e gjelbër dhe energjinë e pastër në vend. Ministria në detyrë e

Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se është lëshuar kësti i fundit nga BE-ja, për të mundësuar disbursimin e mjeteve për 1,435 familje dhe 10 biznese që kanë përfituar në raundin e fundit të subvencioneve për pajisje eficiente të energjisë. "Prej vitit

2022, fillimisht përmes masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës e tutje me mbështetje të Bashkimit Evropian, kemi përkrahur mbi 43 mijë familje dhe biznese me mbi 19.6 milionë euro, duke ulur kostot e energjisë dhe përmirësuar kushtet e jetesës në mbarë

vendin. Një falënderim i veçantë për Bashkimin Evropian për partneritetin e vazhdueshëm dhe besimin që e bën të mundur realizimin e programeve të tilla që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve tanë", ka shkruar Rizvanolli në "Facebook".



TRUMP: ZELENSKY ËSHTË SHITËSI MË I MADH NË BOTË, PUTIN NUK DO TË TAKOHET ME TË

Në njërën anë të Atlantikut, shfaqja, në anën tjetër, përpjekja për të organizuar një takim midis Zelensky-t dhe Putinit.

Shtetet e Bashkuara mbeten protagonist kryesor. Presidenti amerikan Trump shpërtheu me zemërim kur foli me gazetarët në Zyrën Ovale për presidentin ukrainas Zelensky: Ai është “shitësi më i madh në botë” dhe kaloi në ofensivë. Mbi të gjitha, sipas Trump, “sa herë që largohet nga Shtëpia e Bardhë, ai merrte me vete miliona dollarë”. Megjithatë, tani SHBA-të “nuk shpenzojnë më para për Ukrainën”.

Ndërkohë, në Kiev, presidenti Zelensky u takua me të dërguarin special të SHBA-së, Keith Kellogg, dhe dha një mesazh falënderimi dhe shprese në platformën X: “Ne e vlerësojmë gatishmërinë e Shteteve të Bashkuara për të qenë pjesë e arkitekturës së sigurisë për Ukrainën, dhe ekipet tona po punojnë në mënyrë aktive për ta formësuar atë.

Ne presim që themelet kryesore të sigurisë të përcaktohen së shpejti.”

Delegacionet ukrainase dhe amerikane pritët të takohen në fund të javës për të diskutuar perspektivat për bisedimet e ardhshme midis Kievit dhe Moskës.

Megjithatë, pasiguria vazhdon të mbizotërojë mbi mundësinë



e një takimi mes presidentit rus Putin dhe presidentit ukrainas Zelensky. “Putin nuk dëshiron të takohet me Zelensky-n sepse nuk e pëlqen atë,” deklaroi Trump, duke shtuar se ka folur përsëri me presidentin rus pas samitit që pati në Shtëpinë e Bardhë me Zelensky-n dhe udhëheqësit evropianë.

“Tani më quajnë presidentin e Evropës,” shtoi ai. Dhe vijoi: “Të gjitha bisedat me të janë të mira, dhe pastaj një bombë tjetër bie mbi Kiev ose ndonjë qytet tjetër.” Qëndrimi i paqartë i Moskës nuk e dekurajon Uashingtonin. “Ne do ta

kryejmë punën,” tha Trump.

Kievi thekson mospërputhjen e qëndrimit të Rusisë me premtimin për t’i dhënë fund pushtimit të Ukrainës nëse ajo dorëzon rajonet e Donetskut dhe Luganskut. “Nuk besoj se ato që tha pala ruse, domethënë se janë të gatshëm të ndalojnë pushtimin, janë lëshime,” deklaroi Zelensky para një takimi me zëvendëskancelarin dhe ministrin e Financave gjerman, Lars Klingbeil. Ai shtoi se nuk e konsideron “faktin që ata po na ofrojnë të tërhiqemi nga territoret që Rusia nuk i kontrollojnë” si një kompromis.

Evropianët po mblidhen rreth Kievit, megjithë kontradiktat. Këtë mbrëmje, ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani, zhvilloi një bisedë telefonike me homologët e tij nga SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Finlanda dhe Ukraina, për të shqyrtuar situatën në Ukrainë. Tajani përsëriti propozimin për zgjerimin e Nenit 5 dhe për forcimin e forcave të armatosura të Kievit.

Klingbeil i premtoi Ukrainës se Gjermania do të marrë pjesë në ofrimin e garancive të sigurisë në rast të një marrëveshjeje

paqeje. Megjithatë, ai këmbënguli se duhet të fillojnë përgatitjet e përbashkëta nëse Putini nuk është i gatshëm t’i japë fund luftës. Berlioni ka nevojë për “garanci të besueshme sigurie që do të sigurojnë paqe të qëndrueshme për Ukrainën”, shpjegoi Klingbeil, duke shtuar se “Gjermania do të marrë përsipër përgjegjësitë e saj”. Përfaqësuesi i SPD-së, megjithatë, shmangu të përgjigjej nëse Berlioni është gati të dërgojë trupa.

Edhe Stokholmi përsëriti mbështetjen e tij për Kievin. Qeveria suedeze ka rënë dakord për një marrëveshje të re me BE-në për të siguruar rreth 67 milionë euro për të mbuluar boshllëkun e financimit në buxhetin shtetëror të Ukrainës, përmes Instrumentit të BE-së për Ukrainën.

Ndërkohë, pozicioni i Varshavës është i ndërlikuar nga zhvillimet politike të brendshme. Qeveria polake ka paralajmëruar se nuk do të jetë më në gjendje të paguajë për sistemin e internetit satelitor Starlink të Ukrainës, për shkak të vetos së vendosur nga presidenti i ri, nacionalisti Karol Nawrocki i partisë PiS, ndaj një projektligji që zgjaste ndihmën për refugjatët ukrainas deri në mars. Projektligji përfshinte gjithashtu 43 milionë euro financim për sistemin Starlink.

GAZETARJA JEP DORËHEQJEN NGA “REUTERS” PAS 8 VITESH: TURP, PO I SHËRBEN PROPAGANDËS IZRAELITE

Fotoreporterja kanadeze Valerie Zink ka dhënë dorëheqjen nga agjencia e lajmeve “Reuters”, pas tetë vjetësh si bashkëpunëtoresh, duke thënë se nuk mund të punojë më për një agjenci që justifikon dhe mundëson goditjen sistematike të gazetarëve nga Izraeli në Gaza. “U detyrohem kolegëve të mi në Palestinë të paktën kaq”, thotë Zink. Ajo e njoftoi vendimin në një postim në llogarinë e saj personale në “X”.

Zink, e cila ka punuar dhe për media të tjera prestigjioze si “New York Times”, “Al Jazeera” dhe media të ndryshme në Amerikën e Veriut, Evropë dhe Azi, kritikoi raportimin e “Reuters”-it, duke thënë se agjencia është bashkëfajtorë në vrasjen e 246 gazetarëve nga Izraeli që nga fillimi i sulmit ndaj Gazës në tetor të vitit 2023.

“Reuters” zgjodhi të publikojë pretendimin krejtësisht të papabazuar të Izraelit se Al-

Sharif ishte një operativ i Hamasit, një nga shumë gënjeshtër që media si ‘Reuters’ kanë përsëritur me përpikëri dhe i kanë dhënë dinjitet,” shkroi Zink.

Gazetarja theksoi se mediat perëndimore janë direkt përgjegjëse për krijimin e kushteve për këto ngjarje, duke cituar Jeremy Scabill, i cili shprehej se mediat kryesore, nga “New York Times” deri te “Reuters”, kanë shërbyer si “një rrugë për propagandën izraelite,” duke pastruar krimet e luftës, duke dehumanizuar viktimat dhe duke braktisur si kolegët e tyre ashtu edhe angazhimin e tyre për raportim të vërtetë dhe etik.

Gazetarja shprehet se “E kam vlerësuar punën që kam sjellë për ‘Reuters’ gjatë tetë viteve të fundit, por në këtë pikë nuk mund ta imagjinoj veten duke mbajtur këtë kartë të shtypit pa ndërë vetëm turp dhe pikëllim të thellë”.

Ajo tha se mediat perëndimore, duke “përsëritur



trillimet gjenocidale të Izraelit pa vërtetuar nëse kanë ndonjë besueshmëri” dhe duke braktisur përgjegjësinë themelore gazetareske, kanë mundësuar vrasjen e më shumë gazetarëve në Gaza

gjatë dy viteve sesa në konfliktet e mëdha globale së bashku, duke kontribuar gjithashtu në vuajtjet e popullsisë.

Vdekjet e reja nga personeli mediatik në Gaza e kanë çuar

numrin e gazetarëve palestinezë të vrarë në sulmet izraelite që nga tetori i vitit 2023 në 246. Ndërkohë Izraeli ka vrarë më shumë se 62 mijë e 700 palestinezë në Gaza që prej të njëjtës periudhë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Krasniqi huazohet te Legia Varshava

Ermal Krasniqi, përfaqësuesi i Kosovës dhe ish-lojtar i Sparta Pragës, është huazuar te Legia e Varshavës për sezonin 2025/26 me opsion blerjeje. Ai ka luajtur 45 ndeshje me

klubin çek, përfshirë shtatë në Ligën e Kampionëve ndaj ekipeve si Inter dhe Manchester City. Krasniqi u dallua me Ballkanin, ku fitoi dy tituj kampioni (2022,

2023), përpara se të transferohej te CFR Cluj në janar 2023, me të cilët arriti deri në 1/16 e finales së Ligës së Konferencës. Ndërsa për Kosovën ka luajtur 8 ndeshje

dhe ka shënuar 2 gola, me debutim në nëntor 2022. Ai do të mbajë fanellën me numrin 77 te Legia dhe shpreson të ndihmojë klubin të rikthejë titullin.



LEON AVDULLAHU ZGJODHI KOSOVËN, ZHGËNJEHET ZVICRÄ



Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 GUSHT - Ylli i futbollit evropian, Leon Avdullahu e ka pranuar festën e Përfaqësueses së Kosovës për të veshur fanellën “dardane”. Lajmin e ka bërë të ditur presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. “Pritjes i erdhi fundi, Leoni është i Kosovës”, kështu e ka filluar Ademi postimin në “Facebook”. Numri një i futbollit kosovar ka deklaruar se Leon Avdullahu dëshmoi se Kosova mbetet zgjedhje zemre dhe se identiteti e prejardhja nuk mohohen. “Ndjej kënaqësi të ndaj me ju lajmin e madh se Leon Avdullahu, i udhëhequr nga zemra e tij, ka vendosur që të luaj për Kombëtaren e Kosovës. Leoni më njoftoi sonte për vendimin e madh, që pason takimin që kishim pak kohë më parë kur edhe i kishim diskutuar të gjitha gjërat. Leoni me këtë vendim dëshmoi edhe një herë fuqishëm që Kosova mbetet zgjedhje zemre dhe se identiteti e prejardhja nuk mohohen. Mirë se vjen Leon, le të nisim së bashku një rrugë të gjatë e të suksesshme për ekipin kombëtar të Kosovës dhe për Ty. Të priftë e mbara me Kosovën!”, ka shtuar Ademi. Në anën tjetër



Zvicra e kanë përjetuar rëndë këtë humbje, duke e konsideruar atë si një “shuplakë të rëndë” për Federatën Zvicerane të Futbollit. “Leoni na informoi për vendimin e tij. Jemi të zhgënjyer që ai tash dëshiron ta ndjekë një rrugë tjetër. Ne i duam në Kombëtare vetëm ata lojtarë që identifikohen 100 për qind me vendin dhe kombin tonë”, u shpreh për mediat zvicerane Pierluigi Tami, drejtor i ekipit kombëtar të Zvicrës. Për vendimin e futbollistit foli edhe menaxheri i Avdullahut, Sascha Fischer. ky I fundit ka thënë se ky vendim nuk ishte kundër

Zvicrës, por për Kosovën. “Unë natyrisht se e kuptoj emocionin dhe zhgënjimin që shumëkush në Zvicër ndoshta e ndien tash për tash. Leoni është rritur në Zvicër, është formuar këtu dhe Zvicra për të gjithmonë do të mbetet atdheu i tij”, ka thënë menaxheri për portalin zviceran “20 Minuten”. “Ky nuk ishte një vendim kundër Zvicrës, por për Kosovën. Shpesh në futboll dëgjojmë se lojtarët i ndjekin vetëm paratë dhe karrierën. Në këtë rast është e kundërta, Leoni ka vendosur nga bindja e tij, nga zemra dhe nga identiteti familjar që ta përfaqësojë Kosovën”, ka shtuar Fischer.

Shkurt

Karateistet fitojnë tri medalje në Evropianin Universitar për sportet luftarake

Karateistet e Kosovës kanë fituar tri medalje në Evropianin Universitar për sportet luftarake, prej tyre një të argjendtë dhe dy të bronzta, që është bilanc i shkëlqyeshëm nga karateistet “dardane” në Kampionatin Evropian Universitar për sportet luftarake, që u mbajt në Varshavë të Polonisë. Behije Mustafa fitoi të argjendtën në kategorinë -68 kg. Në të njëjtën kategori, Vlera Qerimi u ngjit në podium me medaljen e bronzit. Sukses arriti edhe ekiporja, që fitoi medaljen e bronzit. Komiteti Olimpik i Kosovës ka përgëzuar vashat e Kosovës, trajnerin Nazmi Gashi dhe Federatën e Sportit Universitar të Kosovës për suksesin e arritur.

KB Ylli fillon përgatitjet për sezonin e ri

Pas Borës, Bashkimit e Pejës, edhe Golden Eagle Ylli ka nisur përgatitjet për sezonin 2025/26 në Superligën e Kosovës në basketboll. Ekipi nga Suhareka ka njoftuar se janë kthyer në palestër për t'u bërë gati për sezonin, në të cilin synojnë titullin e kampionit për shkak se festojnë 50 vjetorin e themelimit të klubit. Mbi dhjetë basketbollistë janë paraqitur nën urdhrat e trajnerit nga Greqia, Fotis Takianos, i cili ende nuk e ka kompletuar ekipin, gjë që pritet ta bëjë gjatë kësaj jave. Ylli, tashmë ka konfirmuar shtatë lojtarë për sezonin e ri, i cili nis muajin tjetër, ku pesë janë vendorë dhe dy të huaj. Gëzim Morina, Arian Qallaku, Artin Gashi, Lis Shoshi e Erjon Kastrati do ta bartin fanellën e Yllit, sikurse edhe Lovre Bashiq e Dwayne Cohill për sezonin 2025/26.

Juve me ofertë zyrtare për Zhegrovën

Skuadra e Juventusit po i bën presion Lillet për transferimin e Edon Zhegrovës, futbollist që po e sheh si zëvendësim adekuat për Nico Gonzalezin. Mediumet italiane raportojnë, se Juventusit e Lille janë vazhdimisht në kontakte, të cilat do të bëhen intensive të mërkurën dhe të enjten. Në fakt, Juventusit do t'ia prezantojë Lillet ofertën zyrtare për Zhegrovën, duke ofruar 20 milionë euro, aq sa francezët po kërkojnë minimalisht për kartonin e yllit të Kosovës. Juventusit po shpreson që deri të premten ta mbyll marrëveshjen me Lillen dhe ta prezantojë Zhegrovën, me të cilin veçse ka marrëveshje personale. Zhegrova është pajtuar me kontratë deri në vitin 2030 dhe pagë vjetore prej 2.5 milionë eurosh tek Juventusit, ndërsa po pret vetëm dritën jeshile nga Lille për të realizuar transferimin në Torino.

Asllani: Interi do të mbetet gjithmonë në zemrën time

Torino, 26 gusht - Kristjan Asllani i ka dhënë zyrtarisht lamtumirën Interit, pas huazimit të tij te Torino. Mesfushori kuqezi publikoi në rrjetet e tij sociale një letër prekëse për tifozët zikaltër, ku falënderon klubin, shokët e skuadrës dhe stafin për përvojën e veçantë në Milano. “Të dashur tifozë të Interit, ka ardhur koha t'ju them lamtumirë dhe më besoni, nuk është e lehtë të gjej fjalët e duhura. Ta vishja fanellën e Interit ka qenë një ëndërr e

imja që kur isha fëmijë, kur brohorisja për këto ngjyra me sytë plot admirim. Sa herë që dilja në fushën e ‘San Siro’, ndieja krenarinë dhe përgjegjësinë e përfaqësimit të një ekipi që do të jetë gjithmonë pjesë e imja. Falënderoj Interin që më dha mundësinë ta realizoj këtë ëndërr”, ka thënë Asani. “Një falënderim i veçantë për bashkëlojtarët e mi, të cilët nuk ishin thjesht një ekip, por familje e vërtetë. Falënderoj gjithë stafin

që më shoqëroi në këtë udhëtim. Gjithmonë jam përpjekur ta nderoj këtë fanellë me përkushtim, sakrificë dhe respekt. Atyre që më mbështetën, iu shpreh mirënjohjen time më të thellë. Po largohem nga Milano, por Interi do të mbetet gjithmonë në zemrën time, sepse kur i do këto ngjyra si fëmijë, nuk ndalesh kurrë së mbajturi me vete. Me dashuri, Kristjan”, ka shtuar Asllani.



Sevilla dhe Udinese në garë për Bajramin

TIRANË, 26 GUSHT - E ardhmja e Nedim Bajramit në Skoci mbetet e paqartë. Mesfushori i kombëtares shqiptare nuk ka arritur të bindë plotësisht te Rangers dhe së fundmi është lënë jashtë listës së skuadrës, duke nxitur zërat për një largim të mundshëm në këtë

merkato. Sipas raportimeve të “Transferfeed” në Britani, për 25-vjeçarin ka interes serioz nga Sevilla në La Liga dhe Udinese në Serie A. Klubi skocez mund të pranojë ta shesë lojtarin nëse mbërrin një ofertë mes 4 dhe 5 milionë eurove, shumë që do t’i lejonte

të rikuperonin investimin e bërë verën e kaluar, kur Bajrami u transferua për rreth 4 milionë euro. Mesfushori shqiptar ka kontratë me Rangers deri në maj 2028, ndërsa sipas “Transfermarkt”, vlera e tij aktuale në treg vlerësohet rreth 3 milionë

euro. Një rikthim në Serie A, ku Bajrami ka shkëlqyer më parë me fanellat e Empolit dhe Sassuolos, ose një aventurë e re në La Liga, mund të jenë skenarët më të mundshëm për të ardhmen e një prej asistimeve më të rëndësishme të mesfushës së Shqipërisë.



Agjenti i Xhakës: Ja pse Graniti e la Leverkusennein dhe u transferua në Sunderland

SUNDERLAND, 26 GUSHT - Kur Granit Xhaka i habiti shumë njerëz duke shkëmbyer kampionët e Bundesligës, Bayer Leverkusen, me Sunderlandin e sapongjitur në Ligën Premier këtë verë, në të gjithë Evropën u ngritën vetullat në befasi. Si mundet një nga mesfushorët më me përvojë të Evropës, i sapoardhur nga gara për trofe në Gjermani, të shkëmbejë futbollin e Ligës së Kampionëve për një betejë të mundshme për rënie nga kategoria në Angli? Për të gjetur përgjigjet, faqja “Flashscore” foli ekskluzivisht me agjentin e Xhakës, Jose Noguera, i cili hodhi dritë mbi motivet pas këtij transferimi dhe vizionin që e bindi klientin e tij të merrte përsipër një nga sfidat më të guximshme të karrierës së tij.



Cfarë e shtyu Xhakën të vendoste të largohej nga Bayer Leverkusen pas një periudhe të suksesshme?
Noguera: Pas dy vitesh, Xhakës i duhej një sfidë e re. Kjo ishte bindja e tij.

Si e bindi Sunderland atë, cila ishte propozimi i tyre?
Noguera: Biseda e parë ishte në telefon me pronarin, Kyril Louis-Dreyfus, i cili është gjithashtu nga Zvicra dhe shumë i ri. Xhaka u lidh shumë mirë me Louis-Dreyfus dhe e pëlqeu vizionin që iu prezantua.

Në çfarë pike dëgjoi Xhaka për interesin e Sunderlandit dhe sa shpejt lëvizën gjërat pas kësaj?
Noguera: Kyril Louis-Dreyfus e telefonoi Xhakën drejtpërdrejt dhe e pyeti nëse do të ishte i interesuar të fillonte projektin e Sunderlandit me të. Xhaka më pas e referoi tek unë, agjenti i tij, dhe më pas filluan diskutimet.

A kishte interes nga klubet e Ligës Premier ose të Ligës së Kampionëve për nënshkrimin e Xhakës?
Noguera: Xhaka kishte shumë

interes nga klubet e Ligës Premier dhe Ligës së Kampionëve dhe refuzoi tre oferta të mëdha për t’u bashkuar me Sunderland këtë verë.

Sa rëndësi pati projekti dhe ambiciet e ardhshme të Sunderlandit në vendimin e tij?
Noguera: Xhaka zakonisht luan në klube ku bëhet fjalë për Ligën e Kampionëve, tituj lige, finale kupash etj. Megjithatë, ai donte të provonte diçka të re sepse dëshiron të bëhet trajner në të ardhmen. Kështu që ai e sheh këtë si një përvojë të re për të mësuar.

Cfarë roli luajti familja e Xhakës

në vendimin e tij për t’u bashkuar me Sunderlandin?
Noguera: Familja e Xhakës luajti një rol shumë të madh që ai të bashkohej me Sunderlandin. Pasi gruaja dhe tre fëmijët e tij ishin të gatshëm të bënin transferimin me të, ai pranoi sepse familja e tij është shumë e rëndësishme për të.

Si e sheh ai Ligën Premier krahasuar me Bundesligën?
Noguera: Futbolli në Angli luhet në një nivel shumë të lartë. Ka më shumë të bëjë me fizikalitetin dhe ndoshta më pak me aspektin teknik. Shumë lojtarë të mëdhenj vijnë në Angli dhe e kuptojnë se duhet të përmirësojnë nivelin e tyre dhe shpesh u duhet kohë për t’u përshtatur.

SHKURT

Roger Federer bëhet miliarder

Legjenda e tenisit, Roger Federer, është futur në listën e sportistëve miliarderë, duke u bërë i shtati në histori që arrin këtë status. 44-vjeçari u tërhoq nga tenisi në vitin 2022 pas një karriere të shkëlqyer, ku fitoi 130 milionë dollarë nga çmimet në fushë. Pjesa më e madhe e pasurisë së tij vjen nga marrëveshjet me sponsorë si Uniqlo, Rolex, Mercedes-Benz dhe investime të suksesshme, përfshirë markën sportive On, ku zotëron 3% të aksioneve. Pasuria neto e Federerit sipas Forbes kap vlerën e 1.1 miliardë dollarëve. Ai bashkohet me emra si Michael Jordan, LeBron James dhe Tiger Woods në elitën e sportistëve me pasuri mbi një miliard.

David pasi debutoi me gol te Juventus: E prisja një start të tillë

Juventus i nisi sezonin e ri në Serie A me këmbën e mbarë, duke mposhtur Parmën (2-0). Një nga protagonistët e suksesit bardhezi ishte Jonathan David, i cili nuk humbi kohë për të lënë gjurmë në aventurën e tij të re, duke shënuar golin e parë me fanellën e “Zonjës së Vjetër” në debutim. “Gjëja më e rëndësishme janë tre pikët, por jam i lumtur që arrita të shënoj në ndeshjen time të parë. Tifozët na mbështetën pa pushim dhe kisha shpresuar për një start të tillë”, u shpreh sulmuesi kanadez pas ndeshjes. David gjithashtu ka shprehur dëshirën për të dhënë maksimumin gjatë gjithë sezonit: “Qëllimi im është të ndihmoj ekipin, si në mbrojtje ashtu edhe në sulm, dhe të jap gjithmonë më të mirën. Shpresoj të vazhdojmë në këtë rrugë dhe të arrijmë sa më shumë fitore”.

Vardy është synim i Cremoneses

Cremonese po ëndërron të sjellë në Serie A sulmuesin anglez Jamie Vardy. Ky nuk është vetëm një transferim fantazie, por ideja më e fundit nga skuadra e Davide Nicola-s për të forcuar sulmin. Orët e fundit është bërë kontakti fillestar midis palëve, me ish-kapitenin e Leicester, me shpresën se do të pranojë një transferim në Itali. Klubi po ëndërron shumë, duke shpresuar të tejkalojë konkurrencën dhe t’i japë trajnerit Nicola një sulmues që ka shënuar më shumë se 200 gola në karrierë. Pas fitores së tyre debutuese në Serie A, në “San Siro” kundër Milanit, ekipi i Cremoneses nuk dëshiron të ndalojë së ëndërruari. Ata po kërkojnë një sulmues dhe e kanë identifikuar sulmuesin anglez si një zgjidhje të mundshme, të preferuarin e tyre aktual. Një lojtar i lirë pas rënies së Leicester nga kategoria, Vardy shënoi 10 gola dhe dha 4 asistime sezonin e kaluar. Tani, në moshën 38-vjeçar, ai është duke kërkuar një sfidë të re dhe Cremona mund të jetë shtëpia e tij e re.

Hollywood do të përgatisë një film për Kobe Bryant

Kompania e njohur kinematografike “Warner Bros”, ka blerë të drejtat për skenarin e një filmi, që tregon historinë se si ylli i Lakersave, Kobe Bryant, u refuzua nga New Jersey Nets dhe përfundoi në Los Angeles. Një film për karrierën e Kobe Bryant do të ishte afërsisht sa

gjatësia e filmit “Lufta dhe Paqja”. Madje ndoshta gjashtë orë e tridhjetë minuta nuk do të ishin të mjaftueshme. Kjo është arsyeja pse “Warner Bros” ka siguruar skenarin për një film që do të përqendrohet ekskluzivisht në ditën e draftit të Bryant. Titulli i përkohshëm është

“Me Zgjedhjen e 8-të”. Zgjedhja e tetë në atë draft ishte në pronësi të New Jersey Nets, të trajnuar nga John Calipari. Ekipi, i cili më vonë u zhvendos në Brooklyn, dukej i vendosur të nënshkruante me Kobe, por menaxheri i përgjithshëm John Nash u “nda” nga

trajneri, i cili preferoi të përqendrohej te Kerry Kittles. Kështu, djali i Jellybean përfundoi në Charlotte me zgjedhjen e 13-të, e cila më pas e shkëmbeu atë me Lakers në këmbim të Vlade Divac. Marrëdhënia e Bryant me kinemanë ishte e fortë edhe para vdekjes së tij

tragjike. Ai fitoi një Oscar për “Dear Basketball”, një film i shkurtër i animuar për tërheqjen e tij nga basketbolli, të cilin ai e shkroi dhe e rrëfeu. Kobe, i cili vdiq kur helikopteri i tij u rrëzua në kodrat pranë Los Angeles më 26 janar 2020, do të mbushte 47-vjeç më 23 gusht.

Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
Shërbimi Pronësor Juridik
Direktorat za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine - Imovinska pravna sluzba

02.Nr. 060/01-3240-6/25
Datë: 15.08.2025

Në bazë të Nenit 8, Paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-139, të datës 26.03.2009, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-205, të datës 28.10.2010; dhe në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës si Organ për Shpronësim 02 Nr.941/01-18567/25; dhe në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datës 28.02.2025, për qëllimin e ndërtimit të Kolektorit/Impiantit të ujërave të zeza për nevojat e banorëve të fshatit Brezne, më datën 15.08.2025 miratohet ky:

V E N D I M

Për shqyrtimin e mëtejshëm të iniciativës së Komunës së Dragashit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

1. Miratohet për shqyrtim të mëtejshëm: Iniciativa e Komunës së Dragashit bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës 02 Nr.941/01-18567/25, në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datës 28.02.2025, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për realizimin e qëllimit publik për ndërtimin e kolektorit/impianitit të ujërave të zeza për nevojat e banorëve të fshatit Brezne;

2. Objekt i këtij Vendimi është shpronësimi i tërë Njesisë Kadastrale P-70604004-00750-0, të pronarit Hamdi Krasniqi (Alim) nga fshati Brezne, Komuna e Dragashit, në vendin e quajtur "Parkaq te mullini", livadh i klasës së 4-të me sipërfaqe totale 1987 m²;

3. Brenda afatit prej 15 ditësh, Vendimi i Kryetarit së bashku me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datës 28.02.2025, dhe dokumentet e tjera të nevojshme, do t'i dorëzohen Zyrrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme që vepron në kuadër të Ministrisë së Financave;

4. Brenda afatit prej 10 ditësh, Organi për Shpronësim - Shërbimi Pronësor Juridik do t'i dorëzojë palës së emëruar në Pikën 2 të këtij Vendimi, Vendimin e Kryetarit së bashku me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datës 28.02.2025, dhe dokumentet e tjera të nevojshme, në përputhje me Nenin 8.7 të Ligjit për Shpronësim;

5. Organi i Shpronësimit dhe Shërbimi Pronësor Juridik, bazuar në kompetencat e tyre, në përputhje me Nenin 8.7 dhe Nenin 3.1, janë të detyruar të përgatisin një Njoftim në të cilin do të përshkruhet dhe arsyetohet qëllimi publik/interesi publik për të cilin është iniciuar procedura e shpronësimit, dhe do t'i informojnë të gjitha palët - pronarët ose mbajtësit e interesit, pra personat që pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën e përmendur, që mund të japin komente ose vërejtje në formë të shkruar lidhur me shpronësimin e përmendur;

6. Gjithashtu, Organi i Shpronësimit - Shërbimi Pronësor Juridik do t'i njoftojë pronarin (mbajtësit potencialë të interesit) dhe palët e interesuara për pronën në fjalë, se do të mbahet një diskutim publik lidhur me shpronësimin e pronës së paluajtshme në vendin ku ndodhet prona;

7. Brenda afatit prej 10 ditësh pas miratimit të këtij Vendimi, Organi i Shpronësimit - shërbimi i autorizuar - do ta publikojë këtë Vendim në njërin nga gazetat ditore me tirazhin më të madh në Kosovë.

**Organi i shpronësimit
Kryetari i Komunës: Dr. Bexhet Xheladini**

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Brupharm" SH.A. me nr. të biznesit 810010166 Bënë uljen e kapitalit nga 2,000,000€ siq ishte më parë bëhet 20,000€.

Kastriot Buçaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "At Gjergj Fishta" Bishtazhin Gjakovë nga kl. 1-5 dhe nga kl. 6-9.

Mark Gjini shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Anton Çeta" Dol Gjakovë nga kl. 1-8.

Altin Llolluni shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti,

banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimi pronësor juridik
Direktorat za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine - Imovinska pravna sluzba -

02 Nr.941/01-18567/25
15.08.2025

NJOFTIM

Në bazë të Nenit 8, Paragrafi 7.3 të Ligjit Nr. 03/L-139 të datës 26.03.2009 për Shpronësimin e Pasurisë së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010; dhe në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës si Organ për Shpronësim 02 Nr.941/01-18567/25; dhe në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit Nr. 060/01-3240-6/25 të datës 28.02.2025, për qëllim të ndërtimit të Kolektorit/Impianitit të ujërave të zeza për nevojat e banorëve të fshatit Brezne, më datë 15.08.2025, njoftohen të emëruarit në vendimet e përmendura më lart për sa vijon:

1. Komuna e Dragashit, si Organ për Shpronësim, për arritjen e një qëllimi publik dhe legjitim, në mënyrë që të sigurojë nevojat e banorëve të fshatit Brezne dhe për sigurimin e pasurisë së paluajtshme për ndërtimin e Kolektorit/Impianitit të ujërave të zeza, ka miratuar Vendimin 02 Nr.941/01-18567/25, të datës 14.08.2025, për shqyrtimin e mëtejshëm të ligjshmërisë së shpronësimit të njesisë kadastrale me të dhënat e mëposhtme: **P-70604004-00750-0 ZK Brezne, pronari/mbajtësi Krasniqi Hamdi (Alim), në vendin e quajtur "Parkaq te mullini", livadh i klasës së katërt, me sipërfaqe totale 1987 m²;**

2. Organi për Shpronësim do të miratojë Vendimin preliminar mbi ligjshmërinë e iniciativës së Komunës për shpronësim brenda 30 ditëve, pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në Nenin 9 të Ligjit për Shpronësimin e Pasurisë së Paluajtshme, për personat e përmendur në hyrje të këtij Njoftimi, në lidhje me organizimin e një debati publik;

3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij/saj me shkrim në lidhje me shpronësimin në fjalë, brenda 10 ditëve kalendarike, pas shpalljes së Vendimit për shqyrtimin e mëtejshëm të shpronësimit Nr. 02 Nr.941/01-18567/25, të datës 15.08.2025, në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një nga gazetat me tirazhin më të madh në Kosovë;

4. Organi për Shpronësim - Shërbimi Pronësor Juridik do të mbajë një debat publik në lidhje me shpronësimin e parcelës që është objekt i iniciativës për nisjen e procedurës së shpronësimit për parcelën e përmendur, për Zonën Kadastrale Brezne, Komuna e Dragashit;

5. Të gjithë personat që janë zyrtarë publikë të Komunës ku do të mbahet debati publik, ose pronarë apo mbajtës të interesave mbi pasurinë që është objekt i shpronësimit, ose avokatë, respektivisht përfaqësues ligjorë të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në debatin publik;

6. Çdo person i përmendur më sipër do të ketë mundësi të arsyeshme për të shprehur mendimin e tij/saj lidhur me shpronësimin e kërkuar, në përputhje me paragrafet 2 deri 4 të Nenit 9 të Ligjit për Shpronësim, me emrat e përmendur si në hyrje të këtij Njoftimi;

7. Debat i publik në lidhje me shpronësimin e kërkuar, të drejtat private dhe të drejtat e tjera mbi pasurinë e paluajtshme/parcelën në fjalë do të mbahet më datë **01.09. 2025, në orën 9:30, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Dragashit;**

8. Në rast se, pas përfundimit të procedurës në përputhje me iniciativën e Komunës së Dragashit, pasuria që është objekt i këtij shpronësimi do të shfrytëzohet, asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e riparimeve të kryera mbi pasuri, ndërtimin ose zgjerimin e objekteve mbi pasuri, ose mbjelljen e pemëve, bimëve apo frutave në parcelën në fjalë, duke filluar nga dita e përmbushjes së dispozitave përkatëse të Paragrafi 8 të Nenit 8b të Ligjit për Shpronësimin, me ndryshimet e përmendura në hyrje të këtij Njoftimi. Çdo person që pretendon se ka ndonjë interes pronësor ose ndonjë interes tjetër ligjor mbi parcelën në fjalë, këshillohet të shqyrtojë Ligjin Nr. 03/L-139. Çdo person që pretendon të ketë ndonjë interes pronësor ose ndonjë interes tjetër ligjor mbi pasurinë në fjalë, këshillohet të shqyrtojë ligjin e përmendur dhe të kërkojë ndihmë juridike profesionale për të kuptuar të drejtën e tij/saj ligjore;

9. Çdo person që nuk është i përmendur në këtë Njoftim dhe pretendon se ka interes të vetin ose ndonjë interes tjetër ligjor mbi parcelën e përshkruar në këtë Njoftim, duhet menjëherë të dorëzojë pranë Organit për Shpronësim/shërbimit të autorizuar (Shërbimi Pronësor Juridik) përshkrimin e pretendimit të tij/saj, bazën ligjore të këtij pretendimi, si dhe kopje të noterizuara të çdo dokumenti lidhur me këtë pretendim.

**Organi për Shpronësim – Kryetari i Komunës
Dr. Bexhet Xheladini**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Ardi Shita” B.I. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811324269 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Ardi Shita” B.I. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811324269 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Ardi Shita” B.I. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811324269 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Sa Corporate Advisory” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810840349 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Sa Corporate Advisory” L.L.C. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810840349 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Sa Corporate Advisory” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810840349 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Eureka Sew” O.P. Ortakëri e përgjithshme, me seli në Muçivërc Kamenicë, pronar Ramiz Thaqi dhe Egzona Thaqi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812023878 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti sa “Eureka Sew” O.P. Mučivërc Kamenicë, pronar Ramiz Thaqi - Egzona Thaqi donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812023878 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that “Eureka Sew” O.P. general partnership headquartered in Muçivërc Kamenicë, owner Ramiz Thaqi and Egzona Thaqi, has come to the decision to quit its business: 812023878 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

